



Prishtinë, 05 maj 2023
Kodi i ZRRE-së: V_1717_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1.8 dhe Nenin 17 paragrafi 1.2, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084); Nenin 50 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031; Vendimin Nr. V_1681_2023 të datës 23.03.2023 të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së; dhe Kërkesën e KOSTT SH.A nr. 626 dt. 28.03.2023 për ndryshimin e Vendimit V_1681_2023 dhe korrigjimin e faturave të jo-balancave, në seancën e mbajtur më 05 maj 2023 nxori këtë:

V E N D I M

- I. Ndryshohet dhe plotësohet dispozitivi nën pikën II. i Vendimit Nr. V_1681_2023 i datës 23.03.2023 me tekstin si në vijim:

“DETYROHET – Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO SH.A.) që t’i paguaj KOSTT SH.A., faturat për jo balanca për muajin korrik, gusht dhe shtator të vitit 2022, në shumën totale prej €11,107,010.20, në afat prej 30 ditësh nga pranimi i këtij vendimi nën pasojat e ekzekutimit me detyrim”.

- II. Pikat tjera të Vendimit Nr. V_1681_2023 i datës 23.03.2023 mbeten të pandryshuara.

- III. Vendimi i ZRRE-së, është i zbatueshëm nga data e nxjerrjes.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejme: ZRRE) me datë 28.03.2023 ka pranuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (në tekstin e mëtejme: KOSTT SH.A.), kërkesën për ndryshimin e Vendimit V_1681_2023 dhe korrigjimin e faturave të jo-balancave për Kompaninë Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (në tekstin e mëtejme: KESCO SH.A.).

KOSTT SH.A., në kërkesën e saj ka sqaruar se pas pranimi të vendimit nr. V_1681-2023 të datës 23.03.2023 lidhur me kontestin e ngritur nga KOSTT SH.A., ndaj KESCO SH.A., nr. 2484 të datës 12.12.2022, KOSTT SH.A., ka konstatuar se në kërkesën për vlerën e kontestit të prezantuar nga KOSTT, ka mospërputhje me gjendjen reale, pasi që në kontestin e ngritur nga KOSTT nuk janë përfshirë faturat korrigjuese për lejimet ndaj KESCO, por janë përfshirë vetëm faturat hyrëse në llogarinë balancuese, Pra sipas KOSTT kjo ka ndikuar që vlera e kontestit të jetë më e lartë se vlera reale (borxhi real).



KOSTT SH.A., ka sqaruar se në vlerat fillestare të dërguara në ZRRE me datën 12.12.2022 të dhënat janë prezantuar si në tabelën 1 të kërkesës në vlerën totale prej €11,445,280.58, ndërsa pas rishikimit nga KOSTT është vërtetuar se mungojnë korrigjimet me vlera negative dhe gjendja reale është prezantuar në Tabelën 2 të kërkesës dhe totali i borxhit real për tu paguar nga KESCO është €11,104,953.90.

KOSTT SH.A, në fund ka kërkuar që të ndryshohet vendimi Nr. V_1681_2023 i datës 23.03.2023 për vlerën korrekte të prezantuar në tabelën 2, ndërsa me datë 04.04.2023 përmes shkresë elektronike ka konfirmuar se vlera korrekte dhe e korrigjuar duhet të jetë në shumën prej €11,107,010.20.

Bordi i ZRRE-së, pas shqyrtimit, analizimit, administrimit të kërkesës dhe faturave korrigjuese, vlerëson se duhet të bëhet plotësim ndryshimi i vendimit Nr. V_1681_2023 i datës 23.03.2023 për korrigjimin e vlerave korrekte si në dispozitiv të këtij Vendimi.

IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Ymer Pejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, anëtar


Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- KESCO SH.A, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.